

VENDIM
Nr.218, datë 15.4.2005

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË
SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, dhe të nenit 6 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom””, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektkontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom”.
 2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ALBTELECOM SHA
KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

_____ 2005

Kjo kontratë lidhet më _____ 2005
midis

Ministrit të Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, bulevardi Zhan d’Ark, e përfaqësuar nga Shkëlqesia e Tij, Ministri z. Anastas Angjeli (më poshtë referuar si “Shitësi”) dhe

_____, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të _____, (më poshtë “Blerësi”) me seli në _____, e përfaqësuar nga z. _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor.

MEQENËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE,

a) Albtelecom sh.a. (më poshtë referuar si “Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shtetërore, e krijuar rregullisht sipas së drejtës shqiptare, me seli në Tiranë, rruga Myslym Shyri, nr. 42, me kapital aksionar 17 400 000 000 lekë, të paguar plotësisht;

b) Shitësi është pronar i 17 400 000 aksioneve të zakonshme të shoqërisë, me një vlerë nominale prej 1000 lekë secili, që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë;

c) Blerësi është një shoqëri e specializuar në fushën e telekomunikacionit;

d) Në mbështetje të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”, ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 2.7.2004 “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime Albtelecom, që u ofrohet investitorëve strategjikë”, Shitësi ka për qëllim t’i shesë Blerësit një numër prej 13 224 000 aksione të zakonshme të Shoqërisë, që përfaqësojnë 76% të kapitalit të saj aksionar;

e) Blerësi ka për qëllim të blejë 13 224 000 aksione të zakonshme të shoqërisë, aktualisht të zotëruara nga Shitësi;

duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Përveç termave të tjera të përkufizuara gjetkë në këtë kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtëm:

“Llogari” do të thotë pasqyrat financiare të llogarive të Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur në datën e fundit kontabël;

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë për blerje aksionesh, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur, të nënshkruara e të shkëmbyera nga dhe ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;

“Mbyllje” do të thotë blerja dhe shitja e aksioneve, regjistrimi i Blerësit si aksionar i ri, pagesa e pjesës së çmimit të pagueshëm në datën e mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumenteve, kryerja dhe përmbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për t’u realizuar dhe shkëmbyer, kryer dhe përmbushur në mbyllje, në përputhje me këtë kontratë me qëllim që të mundësojë Blerësin të bëhet pronar legjitim i 76% të aksioneve të Shoqërisë;

“Data e mbylljes” do të thotë data në të cilin aktualisht mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj kontrate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj;

“Konsulentët” do të thotë këshilltarët e Shitësit për transaksionin, objekt të kësaj kontrate, të emërtuar Banca IMI S.p.A., Bain&Company Italy dhe Studio Legate Tonucci-Organizatë Profesionale;

“Parapagesë” do të thotë shuma prej _____ (_____), paguar nga Blerësi në datën e mbylljes siç parashikohet në nenin 3, paragrafi 3, numri 1 i kontratës;

“Barrë” do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të parë, e drejta e parablerjes, e drejtë ose interes e një pale të tretë, barrë ose interesa sigurimi të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, pa kufizim, transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje mbajtje) që kanë pasojë të ngjashme;

“Forca madhore” do të thotë çdo urdhër, rregullore ose direktivë qeveritare, e botuar në formën e ligjit ose jo, ose çdo sanksion me natyrë kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, trazira, trazira civile, luftë (e deklaruar ose jo), aksione ose kërcënime për aksione grupesh ose individësh terroristë apo guerilie, greva ose lëvizje të tjera sindikaliste, zjarre, përmbajtje, tërmete, ose ndonjë shkak tjetër që nuk është rezultat i fajit ose neglizhencës së palëve, ose secilës prej tyre, qofshin ose jo të ngjashme me sa më sipër, me kusht që një ngjarje e tillë të jetë jashtë kontrollit të palës së dëmtuar;

“Data e fundit kontabël” do të thotë 31.12.2004;

“Humbje” ose “Humbjet” do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime, në një shumë jo më të vogël se 50 000 euro (pesëdhjetë mijë), të cilat janë pasojë direkte dhe/ose indirekte e shkeljes së parashikimeve dhe garancive të specifikuar në nenin 5;

“Materiale” (dhe variantet e saj) do të thotë, në lidhje me një ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, se kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, që veçmas ose së bashku, ka një pasojë e ndikim domethënës ose plotësisht të kundërt (përkeqësues) në gjendjen ekonomike, pasurore, financiare dhe tregtare të shoqërisë dhe/ose të veprimtarisë së saj në tërësi, në mënyrë të tillë që vendimi për të kryer transaksionin do të ndikohet në të kundërt kurdo që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht të njihet prej Blerësit, ose që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

“Ndryshim material përkeqësues” do të thotë ndonjë nga ngjarjet në vijim:

a) një vendim i autoriteteve kompetente shqiptare për tërheqje, mbyllje ose pezullim të licencës së shoqërisë, të identifikuar në shtojcën D;

b) një vendim i detyrueshëm ligjor, i formës së prerë i një gjykate, që deklaron shoqërinë të falimentuar ose me paaftësi paguese;

c) fillimi nga shoqëria i akteve të likuidimit, në lidhje me vetë shoqërinë;

d) ndonjë ngjarje ose seri ngjarjesh, që rrjedh si rezultat i menaxhimit apo veprimeve të shoqërisë, që përfshin një pagesë ose humbje, veçmas ose në tërësi, në një shumë jo më të vogël se 1 000 000 euro (një milion);

“Pala” ose “Palët” do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç mund të kërkoet në kontekst;

“Çmimi i blerjes” do të thotë çmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e aksioneve, siç tregohet në nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar aty;

“Deklarata për çmimin e blerjes” do të thotë deklarata e shkruar, në formën e rënë dakord në shtojcën A, të nënshkruar nga drejtuesi përkatës i çdo banke të caktuar nga Shitësi, dhe të treguar në tabelën e paraqitur në nenin 3, që vërteton se çmimi i blerjes është kredituar në llogaritë e Shitësit ose të personave juridikë të tjerë të caktuar nga Shitësi në ato banka;

“Aksione” do të thotë një numër 13 224 000 aksione të zakonshme, plotësisht të paguara të Shoqërisë me një vlerë nominale prej 1000 lekë secili, numër i barabartë me 76 % të kapitalit aksionar të Shoqërisë. Aksionet përfaqësohen nga certifikata bashkëngjitur shtojcës B.

Titujt në këtë kontratë nuk kanë ndonjë ndikim në interpretimin e saj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj kontrate

Në bazë të kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e mbylljes Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi aksionet dhe çdo të drejtë që u përket aksioneve, të lira nga çdo barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe të pagueshme në mënyrën e parashikuar po aty.

Mbyllja e transaksionit të parashikuar në këtë kontratë, që do të kryhet në datën e mbylljes, do të zhvillohet në zyrat e Shitësit në datën për të cilën do të bien dakord reciprokisht palët.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe metoda e pagesës

Çmimi i pranuar për çdo aksion është _____ (_____) dhe, kështu, shuma totale e çmimit të blerjes për aksionet është _____ (_____), dhe do të paguhet në përputhje me dispozitat e parashikuara këtu dhe sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Të drejtat e dividendëve do të lindin për secilin prej aksioneve nga data e mbylljes.

Shitësi do të paguajë totalin e çmimit të blerjes si më poshtë:

1. Në datën e mbylljes, parapagimi do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse nr. _____ e hapur nga Banca IMI S.p.A, Swift Code _____, në Bank _____ Swift Code _____ si pjesë e çmimit total të blerjes;

2. Në datën e mbylljes, shuma prej _____ (_____) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit nr. _____, e hapur me _____ Bank, Swift Code _____;

3. Në ditën e njëqint e tetëdhjetë pas datës së mbylljes, shuma e mbetur prej _____ (_____) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit, të treguar në paragrafin 2.

Nëpërmjet kësaj kontrate, Blerësi është shprehimisht i autorizuar nga Shitësi t'u paguajë parapagimin drejtpërdrejt konsulentëve, në llogarinë bankare të përmendur më sipër, si shpërblim për suksesin për shërbimet këshillimore të konsulentëve në shitjen e aksioneve.

Në datën e mbylljes, Blerësi merr përsipër t'i paraqesë Shitësit një garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve, të lëshuar në favor të Shitësit për shumën e barabartë me shumën e mbetur për t'u paguar sipas paragrafit 3 pika 3, këtu sipër, në formën e përshkruar në shtojcën C.

Neni 4

Mbyllja

Në mbyllje:

a) Shitësi:

1. Do të dorëzojë certifikatën që përfaqëson aksionet e regjistruara rregullisht në favor të Blerësit, në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. Do të nënshkruajë dhe dorëzojë, dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, për t'i dhënë Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi aksionet dhe për të realizuar në mënyrën e duhur qëllimin e kësaj kontratë;

3. Do të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, duke filluar nga data e mbylljes;

4. Do të t'i kthejë Blerësit garancinë bankare për tenderin që i është dorëzuar së bashku me ofertën detyruese.

b) Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit dokumentet e mëposhtme:

1. Mandatpagesën e çmimit të blerjes në shumën e caktuar në nenin 3 paragrafi 3, pikat 1 dhe 2;

2. garancinë bankare në përputhje me nenin 3, paragrafi 5;

3. një ekstrakt nga regjistri tregtar, në lidhje me blerësin, lëshuar brenda 10 (dhjetë) ditësh punë para mbylljes;

4. një certifikatë të noterizuar të pozitës së mirë të Blerësit;

5. një kopje të noterizuar të licencës për telekomunikacion të Blerësit, në vendin e tij të krijimit;

6. një kopje të noterizuar të vendimit të organeve kompetente të Blerësit, që miratojnë blerjen e aksioneve;

7. opinionin ligjor të lëshuar nga (emri i avokatit) në një formë të pranueshme për Shitësin, që konfirmon autoritetin e Blerësit për lidhjen e kësaj kontrate dhe zbatimin e detyrimeve të saj.

Në mbyllje, Blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet, në datën e mbylljes dhe do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga data e mbylljes.

Shitësi do të bëjë të mundur që në datën e mbylljes, ose në çdo datë tjetër pas mbylljes të vendosur nga Blerësi, thirrjen e mbledhjes së aksionarëve të Shoqërisë, rendi i ditës i së cilës do të përcaktohet në marrëveshje me Blerësin dhe do të përfshijë ndër të tjera, emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, në vend të atyre që do të kenë dhënë dorëheqjen; Blerësi do të ketë të drejtën të përcaktojë emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që do të emërohen pa cenuar kufizimet, në qoftë se ka të tilla, të parashikuara në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe në amendamentet e tij të mëvonshme, si dhe në dispozitat e tjera shqiptare statutores të aplikueshme.

Neni 5

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Shitësi me anë të kësaj kontrate deklaron dhe garanton, në lidhje me Shoqërinë dhe me transaksionin të parashikuar prej kësaj kontrate, të gjitha çështjet që vijnë deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklaram do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo çorientues, sikur të ishte bërë në datën e mbylljes.

5.1 Organizimi

Shoqëria është themeluar në mënyrën e duhur dhe ekziston rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në pamundësi pagese, dhe është plotësisht e aftë, me të drejta dhe autoritet të plotë, të zhvillojë e të kryejë aktivitetin e saj siç e kryen aktualisht, dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj siç i zotëron aktualisht. Shoqëria zhvillon aktivitetin sipas një licence të vlefshme, siç tregohet në shtojcën E, dhe nuk ka shkelur asnjë prej afateve të kësaj licence.

5.2 Autorizimi

Të gjitha aktet legjislative dhe/ose procedurat e tjera të kërkuara prej legjislacionit shqiptar për t'u marrë nga Shitësi ose në emër të tij, për ta autorizuar atë të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Shitësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm të Shitësit ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

5.3 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, realizimi i transaksionit të parashikuar nga kjo kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt ose nuk rezultojnë të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përsheptimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë pengesë mbi ndonjë biznes, aset ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite, vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të

zbatueshme për Shitësin.

5.4 Pronësia

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm ligjor i aksioneve në numrin e përcaktuar në nenet 1 dhe 2.

Aksionet janë të përcaktuara dhe të emetuara sipas rregullave dhe janë plotësisht të pagueshme.

Aksionet janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdolloji dhe Shitësi do të ketë të drejtë, kompetencë dhe autoritet të plotë për t'i shitur, për t'ua kaluar pronësinë e tyre të tretëve, transferuar dhe dorëzuar aksionet në përputhje me afatet e kësaj kontrate.

Nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë barrë në lidhje me aksionet ose ndonjë numër aksionesh të autorizuar, por të paometuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon të ketë të drejtën e ndonjë barre në lidhje me ndonjë nga aksionet.

Përveç kësaj kontrate, nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që kërkon krijimin, akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien një personi të së drejtës (të kushtëzuar ose jo) të kërkojë akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Shoqërisë (duke përfshirë, pa kufizim, një mundësi ose të drejtë parablerje ose kthimi).

5.5 Filialet

Shoqëria zotëron 100 % të aksioneve të Eagle Mobile SHA

5.6 Llogaritë financiare

Llogaritë financiare janë përgatitur mbi baza të rregullta e të qëndrueshme, në përputhje me të drejtën shqiptare dhe me praktikën, principet, standardet e aplikueshme lokale.

5.7 Regjistrat kontabël dhe libra të tjerë të shoqërisë

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë, në zotërim ose nën kontrollin e saj, janë të azhurnuar, të mbajtur në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në regjistrat dhe librat kontabël janë mbajtur në përputhje të plotë me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikën e zbatuara ndërkombëtare.

5.8 Mungesa e ndryshimeve materiale

Biznesi i Shoqërisë është zhvilluar në mënyrë normale duke e konsideruar atë si një preokupim të vazhdueshëm; dhe asnjë ndryshim thelbësor nuk ka ndodhur në aktivin dhe pasivin e treguar në llogaritë dhe nuk ka asnjë ulje të vlerës reale neto të aktivitetit të Shoqërisë në bazë të vlerësimeve të bëra dhe të përlllogaritura në llogaritë.

Që nga data e fundit kontabël, Shoqëria është drejtuar dhe ka operuar në mënyrën e duhur dhe Shitësi nuk ka dijeni se vetë Shitësi dhe/ose Shoqëria ka:

- hyrë në ndonjë marrëveshje, vlera e të cilave kalon 100 000 euro, me përjashtim të atyre të raportuar në shtojcën E, ose

- marrë përsipër ndonjë detyrim ose përgjegjësi materiale, ose

- kryer ndonjë veprim tjetër që mund të shkaktojë që ndonjë nga deklaratat ose garancitë e Shitësit që përmbahen në këtë kontratë, të bëhen të pavërteta ose të parregullta.

Që prej 31.3 Shoqëria nuk ka:

- a) pësuar asnjë ndryshim material dhe përkeqësues në asetet, pronat ose në aktivitetet e saj të biznesit;

- b) pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat e saj, që rrezikon materialisht të pengojë, ndalojë, dëmtojë ose të cenojë në ndonjë mënyrë tjetër materiale dhe përkeqësuese rezultatet e veprimtarisë së saj në tërësi;

- c) hyrë në asnjë transaksion ose kontratë, ose nuk ka ndryshuar ose përfunduar asnjë transaksion ose kontratë që në mënyrë të arsyeshme mund të sillte një ndryshim material dhe përkeqësues për asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të saj;

- d) shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose disponuar të ndonjë mënyrë tjetër asetet ose pronat që ajo zotëron;

- e) punësuar personel ose nuk e ka rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm, ose që do të bëhet i tillë ndaj punonjësve, përveç rritjes së bërë sipas praktikave të mëparshme në përputhje me çdo shpërblim ekzistues ose me plane të tjera, ose nuk ka ndryshuar organizimin e punës së saj në asnjë mënyrë materiale;

f) fituar asnjë pasuri të paluajtshme ose nuk ka bërë as edhe një shpenzim kapitali (prekshëm ose të paprekshëm) që kalon shumë 100 000 euro;

g) fituar ose poseduar, në çfarëdoq formë, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk ka fituar, poseduar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë biznes ose pjesë biznesi;

h) deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumë _____ lekë, që është pjesë e dividendit të 2004, ose nuk ka blerë ose fituar në ndonjë mënyrë tjetër interesa në pasurinë e saj (*equity*);

i) rënë dakord për të bërë ndonjë nga të mësipërmet.

Shitësi garanton se ndërmjet datës së ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje dhe mbylljes do të sigurojë që:

a) Shoqëria do të drejtojë biznesin e saj në përputhje me interesat e saj të biznesit dhe në rrugën e biznesit të zakonshëm, nga data e nënshkrimit të marrëveshjes dhe në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, nenet e tij për shoqëritë dhe rregullat e brendshme në të gjitha aspektet materiale dhe

b) Shoqëria mban të pacenuar organizimin, klientët dhe personelin e saj të biznesit.

Shoqëria nuk do të bëjë asnjë shpenzim ose nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim pa miratimin paraprak nga ana e përfaqësuesit të Blerësit.

5.9 Taksa dhe konfliktet

Shoqëria ka depozituar, në kohën e duhur, të gjitha deklaratat për taksat periodike dhe vjetore që parashikohen në ligjet për taksat që zbatohen për Shoqërinë. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe në mënyrën e duhur dhe të gjitha taksat dhe detyrimet direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Për sa më sipër është lëshuar nga autoritetet tatimore shqiptare një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore ashtu siç tregohet në shtojcën F.

Nuk ekziston asnjë konflikt në proces ose potenciali, me përjashtim të atyre të treguara në shtojcën G.

5.10 Asetet e prekshme

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, të renditura në shtojcat H, I, dhe J (duke përfshirë pronat individuale dhe të paluajtshme) që ose janë pasqyruar në llogaritë e datës së fundit kontabël, ose që janë fituar pas kësaj date, dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrimi ose të drejte të çfarëdoq në përfitim të të tretëve.

5.11 Asetet e paprekshme

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive e markave tregtare, patentave, e emrave tregtarë, *know-how* dhe të çdo të drejte tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për zhvillimin e biznesit të saj siç tregohet në shtojcën K, si dhe ka të drejtë t'i përdorë këto dhe nuk ka cenuar asnjë markë tregtare, patentat, emër tregtar dhe *know-how*, dhe asnjë të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale.

Shoqëria është licencuar në mënyrën e duhur për përdorimin e *softwerëve* të saj.

Këto asete të paprekshme janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife ose të ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

5.12 Punonjësit

Të gjithë punonjësit janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës, së bashku me shpërblimet totale që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkohen për t'u bërë ose për t'u ndërmarrë, sipas ligjeve e rregullave të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për punën dhe mirëqenien në lidhje me secilin nga punonjësit, duke përfshirë, për shmangie të ndonjë dyshimi, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 14.8.2001 "Për trajtimin e punonjësve të larguar si rezultat i ristrukturimit të Albtelecom sh.a.-së". Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe të mirëqenies në bazë të ligjeve dhe rregullave, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka të tillë, janë paguar plotësisht.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, bordit të drejtorëve ose çdo ekspert kontabël i Shoqërisë dhe çdo punonjës ka marrë vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në llogaritë dhe asnjë nga ata nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër, përveç atyre të treguara në këto llogari.

5.13. Pajtueshmëria me ligjin

Deri në datën e mbylljes, shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër, dekret, direktiv, leje ose kërkesë të ngjashme të zbatueshme ndaj aseteve dhe pronave (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme ose të paprekshme, të zotëruara, të licencuara, të disponuara me qira ose ndryshe) ose ndaj kontratës dhe të drejtat të parashikuara prej saj, të cilat mund të kenë një ndryshim material përkeqësues mbi aktivitetin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme, pa i shkelur ato, të gjitha lejet materiale, licencat dhe miratimet ose autorizimet e tjera që kërkojnë nga statutet, ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet ose direktivat e zbatueshme, në lidhje me pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e biznesit të saj ose të çdo aseti dhe prone të saj, ose të çdo kontrate dhe të drejte me të cilat Shoqëria është e lidhur.

Procesi i privatizimit të Shoqërisë dhe përzgjedhja e Blerësit si kandidat fitues kryhet në përputhje me ligjin nr.8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom", i ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

5.14 Garancitë, detyrimet dhe dëmshpërblimet

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë kapital hua, as të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, me përjashtim të atyre të treguara në shtojcën L.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje garancie, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose për të marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

5.15 Mbyllja e shoqërisë, vënia në administrim dhe pamundësia e pagesës

Asnjë urdhër nuk është nxjerrë, asnjë ankese nuk është paraqitur, ose asnjë vendim nuk është marrë për mbylljen e Shoqërisë ose për emërimin e ndonjë likuidatori të përkohshëm për Shoqërinë, si dhe asnjë urdhër nuk është nxjerrë për vënie në administrim të Shoqërisë; dhe Shoqëria nuk është e insolvente ose e paafte të paguajë borxhet e saj.

5.16 Pullat e taksës, taksat dhe detyrimet e tjera

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksat ose detyrime të tjera në lidhje me këtë kontratë dhe me transferimin e aksioneve në emër të Blerësit.

5.17 Shtojcat

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje do të konsiderohen si pjesë përbërëse të saj:

Shtojca A: Deklarata e çmimit të blerjes;

Shtojca B: Certifikata e aksioneve;

Shtojca C: Garanci bankare;

Shtojca D: Licenca e Shoqërisë;

Shtojca E: Marrëveshjet e nënshkruara nga Shoqëria, pas datës së fundit kontabël;

Shtojca F: Raporti mbi çështjet tatimore;

Shtojca G: Raporti në lidhje me çështjen në proces;

Shtojca H: Lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;

Shtojca I: Lista e stacioneve ekzistuese bazë të Shoqërisë;

Shtojca J: Lista e pajisjeve dhe aseteve të Shoqërisë (inventari);

Shtojca K: Lista e licencave për markat tregtare, patentat dhe software të Shoqërisë;

Shtojca L: Kontratat e huasë të nënshkruara nga shoqëria;

Shtojca M: Plani i biznesit i Blerësit.

Për të shmangur çdo dyshim, Shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë në datën e mbylljes.

Neni 6

Deklarimet dhe garancitë e Blerësit

Blerësi i bën deklaratimet dhe ia jep garancitë e mëposhtme Shitësit. Secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në datën e mbylljes.

6.1 Organizimi

Blerësi është një shoqëri e themeluar, e organizuar dhe që ekziston rregullisht sipas së drejtës _____, me aftësi paguese, me kompetencë dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e saj, siç e

kryen aktualisht, dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj, siç i zotëron aktualisht.

6.2 Autorizimi

Të gjitha aktet e shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që kërkohet të ndërmerren nga ose për t'u marrë nga ose në emër të Blerësit, për ta autorizuar atë të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitim, aprovimin, autorizimin, ose çfarëdo instrument tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar, ose rregullator të vendit të Blerësit, përveç për _____.

6.3 Mungesa e komisionerëve

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa të ngjashme, ose komisione në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë kontratë, pagimi i të cilave të mund të kërkohej në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria ose Shitësi.

6.4 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, përfundimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga Blerësi nuk bie në konflikt ose nuk rezultojnë në përbërje ndonjë shkelje ose mospërbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përsheptimin të ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, asetet ose pronë a pasuri të Blerësit, sipas ndonjë dispozite të (i) statutit të Blerësit ose të dokumenteve të tjera të themelimit, ose (ii) të ndonjë kambiali, obligacioni, hipoteke, marrëveshjeje, akt i trustit, licence, qiraje, kontrate ose marrëveshjeje, në të cilat Blerësi është palë, ose (iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e Blerësit.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose dhe të vetë akteve të Shoqërisë të Blerësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë ose në forcën detyruese të kësaj kontrate.

6.5 Due Diligence

Blerësi deklaron se ka drejtuar mbikëqyrjen e *due diligence* së biznesit dhe veprimtarisë së Shoqërisë dhe se nuk ka mbështetur dhe nuk është duke u mbështetur në ndonjë deklarament ose garanci nga Shitësi, përveç atyre që përmbahen specifikisht në këtë kontratë.

Neni 7

Detyrime të tjera të Blerësit

7.1 Mbajtja e selisë në Shqipëri

Blerësi do të mbajë selinë e Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

7.2 Investimet dhe plani i biznesit

Blerësi do të zhvillojë, me përpjekjet e tij më të mira, aktivitetet e Shoqërisë, me qëllim që ta bëjë këtë biznes më konkurrues dhe efektiv në treg, në përputhje me planin e tij të biznesit siç përshkruhet në shtojcën M.

Në mënyrë të veçantë, Blerësi do të zbatojë brenda periudhës së parashikuar të paktën 80% (tetëdhjetë) të shumës së investimeve të përshkuara në planin e biznesit.

Në rast se pas tre vjetësh nga nënshkrimi i kësaj kontrate, Blerësi nuk do të ketë plotësuar detyrimet e mësipërme, në lidhje me investimet e parashikuara deri në vitin e tretë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën prej _____ (_____), me përjashtim të rastit kur mosplotësimi i tyre nuk varet prej Blerësit për çfarëdo arsyeje.

7.3 Pronësia mbi aksionet

Blerësi do të vazhdojë të zotërojë aksionet për të paktën _____ vjet, duke filluar nga mbyllja, përveçse kur Shitësi miraton ndryshe. Në rast se Blerësi shkel këtë detyrim, do t'i paguajë Shitësit sasinë prej _____ (_____), me përjashtim të rastit kur shkelja nuk varet prej Blerësit për çfarëdo arsyeje.

Neni 8

Kushtet e mbylljes

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet dhe detyrimi i Shitësit për t'ia shitur ato Blerësit, janë çështje të plotësimit ose i heqjes dorë, në ose përpara datës së mbylljes, të kushteve të mëposhtme.

8.1 Autorizimet

Të gjitha autorizimet, pëlqimet, urdhrat ose miratimet për, ose deklaratat, ose depozitimet, ose skadimi i afateve të periudhave pritëse, të vendosura nga ndonjë entitet ose autoritet qeveritar, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes së aksioneve, do të jenë marrë ose regjistruar, ose do të kenë ndodhur, ose sipas rastit, të hequr dorë prej tyre, nga autoriteti kompetent. Në mënyrë të veçantë:

a) Autoriteti i konkurrencës (vendi i krijimit të blerësit) ose autoritet tjetër kompetent do të ketë lëshuar një vendim që miraton blerjen e aksioneve nga Blerësi, në përputhje me ligjet e aplikueshme të (vendi i krijimit të blerësit).

b) Me kërkesën e Shitësit, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë do të marrë vendimin për ta paraqitur këtë kontratë për ratifikim në Kuvend, ratifikim i cili do të bëhet përpara pagimit të shumës së parashikuar në nenin 3 paragrafi 3, numri 3. Për shmangien e çdo dyshimi, është e kuptueshme që kjo kontratë është perfekte, e vlefshme dhe efektive, pavarësisht nga ratifikimi i saj nga Kuvendi.

8.2 Mungesa e vendimeve ose kufizimeve

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i hyrë në fuqi, i shpallur ose i detyrueshëm ose i nxjerrë nga ndonjë entitet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim a ndalim tjetër ligjor, që pengon ose ndalon kryerjen e blerjes dhe shitjes së aksioneve, nuk do të ketë fuqi juridike.

8.3 Kushtet për detyrimet e Blerësit

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet dhe për të paguar për to në mbyllje, është objekt i plotësimit (ose të heqjes dorë nga Blerësi), në ose përpara datës së mbylljes, të kushteve të mëposhtme:

a) Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit të bëra në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në momentin përkatës të mbylljes, sikur të jenë bërë në atë kohë, përveç rastit kur vlefshmëria e këtyre deklaratave dhe garancive ka shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në këtë datë më të hershme), përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një ndryshim material përkeqësues.

b) Plotësimi i detyrimeve të Shitësit

Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo kontratë për t'u kryer ose përmbushur nga ana e Shitësit në kohën e mbylljes, përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një ndryshim material përkeqësues.

c) Mungesa e proceseve

Në kohën e mbylljes nuk do të ketë procese të filluara e të papërfunduara: (i) që kundërshtojnë, kufizojnë ose ndalojnë shitjen dhe blerjen e aksioneve prej Blerësit, (ii) që ndalojnë ose kufizojnë pronësinë ose menaxhimin prej Shoqërisë të ndonjë pjese materiale të biznesit ose të aseteve të Shoqërisë, (iii) që kërkojnë vendosjen e kufizimeve në aftësinë e Blerësit për të fituar, mbajtur ose ushtruar të drejtat e plota të pronësisë mbi aksionet, (iv) që kërkojnë të ndalojnë Blerësin të kontrollojë efektivisht ndonjë pjesë materiale të Shoqërisë; me kusht që nga ky kusht të jetë hequr dorë nga Blerësi për ndonjë padi, ankim ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga ndonjë entitet qeveritar) dhe në qoftë se Shitësi do t'i sigurojë Blerësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Blerësin, në formë e përmbajtje, për këto padi ose procedime.

8.4. Kushte për detyrimet e Shitësit

Detyrimi e Shitësit për t'ia shitur, transferuar dhe dorëzuar aksionet është objekt i plotësimit (ose i heqjes dorë nga Shitësi), në ose përpara datës së mbylljes, i kushteve të mëposhtme:

a) Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e Blerësit të bëra në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në kohën e mbylljes sikur të ishin bërë në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci i referohen shprehimisht një date më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektat materiale, në këtë datë më të hershme).

b) Plotësimi i detyrimeve të Blerësit

Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur, në të gjitha aspektet materiale, të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo kontratë për t'u kryer ose përmbushur në kohën e mbylljes.

c) Mungesa e procedimeve

Nuk do të ketë procedime të filluara ose të papërfunduara nga ndonjë entitet qeveritar (ose procedime nga ndonjë person tjetër me mundësi të arsyeshme për të pasur sukses), që kundërshtojnë ose kërkojnë kufizimin ose ndalimin e shitjes dhe blerjes së aksioneve, ose që kërkojnë të përfitojnë nga Shitësi në lidhje me blerjen dhe shitjen e aksioneve të ndonjë dëmi që është material në lidhje me Shitësin; me kusht që nga një detyrim i tillë të jetë hequr dorë nga Shitësi në lidhje me ndonjë padi, ankesë ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga një entitet qeveritar) dhe në qoftë se Blerësi i siguron Shitësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Shitësin, në formë dhe përmbajtje, në lidhje me këto padi, ankime ose procedime.

Neni 9

Dëmshpërblimi nga Shitësi

9.1 Detyrimet e Shitësit

Shitësi bie dakord të mos dëmtojë ose të kompensojë Blerësin ose Shoqërinë, sipas rastit, sipas kushte dhe brenda kufijve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo humbje që rrjedh nga ose që varet nga fakte ose rrethanat të ndodhura përpara datës së mbylljes edhe nëse humbja shfaqet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim për t'u paguar nga ana e Shitësit sipas kësaj kontrate do të bëhet i pagueshëm vetëm kur humbja përkatëse, siç vendoset nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, është bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose shkelje e pretenduar e ndonjë deklarate ose garancie nuk i jep të drejtë Blerësit të dëmshpërblehet, në rast se nga kjo shkelje nuk ka rezultuar ndonjë humbje për Shoqërinë, siç vendoset me vendim të gjykatës ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

9.2 Ekskluziviteti dhe ndalimi i dublimit të mjeteve mbrojtëse

Është rënë dakord që e drejta për të marrë dëmshpërblim sipas kësaj dispozite përjashton dhe nuk do të dublohet nga ndonjë e drejtë, mjet mbrojtës, pretendim ose mënyra të tjera mbrojtëse të mundshme për Blerësin në lidhje me shkeljen nga ana e Shitësit të deklarimeve dhe garancive të specifikuar në nenin 5.

9.3 Përjashtimet dhe kufizimet

Detyrimi për dëmshpërblim i Shitësit sipas kësaj kontrate, do të hyjë në fuqi vetëm kur shuma totale e humbjeve, objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e Blerësit në tërësi, e kalon shumën 1 000 000 (një milion) euro, me kusht që, nëse ky limit kalohet, Shitësi do të jetë përgjegjës ose i detyruar të paguajë vetëm shumën mbi kufi.

Në asnjë rast shuma totale që duhet të paguhet nga Shitësi si dëmshpërblim në bazë të këtij neni, nuk do t'i kalojë 20 (njëzet) % të çmimit të blerjes.

Shumës që duhet të paguhet nga Shitësi sipas kësaj dispozite, në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, do t'i zbritet: (i) çdo shumë që Shoqëria ka marrë në bazë të çdo politike sigurimi që është në fuqi në datën e kësaj kontrate ose nga çdo palë e tretë në lidhje me çështjen specifike që është objekt i kërkesës për dëmshpërblim ndaj Shoqërisë; (ii) çdo përfitim nga taksat në favor të Blerësit ose të Shoqërisë, si rezultat i ngjarjes që solli pagimin e dëmshpërblimit.

Shitësi do të ketë të drejtën e kompensimit, ndaj çdo humbjeje, e cila është objekt i një pretendimi nga ana e Blerësit, të shumës së çdo aset apo kredie të rastësishme, që rrjedh ose varet nga rrethanat ose veprimet e ndodhura ose të ndërmarra përpara datës së fundit kontabël dhe që nuk janë pasqyruar në llogaritë.

Në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklaratave dhe garancive, njoftimi i të cilave i është dhënë Shitësit pas 12 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

9.4 E drejta e Shitësit në lidhje me humbjet

Blerësi bie dakord të njoftojë Shitësin për çdo fakt që mund t'i shkaktojë Shoqërisë një humbje për t'u dëmshpërblyer, për të cilën Shitësi mund të konsiderohet përgjegjës, menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht që, në rast se afati i fundit për të depozituar një ankesë ose kundërshtim në lidhje me këtë humbje është më pak se

30 (tridhjetë) ditë, njoftimi duhet t'i jepet Shitësit sipas kësaj kontrate nga Blerësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data që ai ka marrë dijeni për këtë njoftim me shkrim, ku të tregohen pretendimet që ai synon të bëjë në mënyrë të detajuar dhe të arsyeshme, së bashku me gjithë dokumentacionin që disponon, i cili mund të jetë i nevojshëm për të mundësuar Shitësin për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me humbjen që është objekt i kësaj kërkesë. Për qëllimin e kësaj dispozite, dijenia e Shoqërisë do të konsiderohet të jetë edhe dijenia e Blerësit.

Shitësi ka të drejtë të bëjë menaxhimin e rrethanave, të cilat janë shkak për ngritjen e pretendimeve nga ana e Blerësit dhe Blerësi bie dakord të sigurojë, në bazë të kërkesës së Shitësit, se Shoqëria do të: (i) mbajë Shitësin të informuar rregullisht dhe menjëherë për çdo njoftim, komunikim ose informacion tjetër në çdo mënyrë të marrë nga Shoqëria, në lidhje me një pretendim të tillë; (ii) bashkëpunojë me Shitësin, në lidhje me zhdëmtimet dhe veprimet përkatëse, duke i dhënë Shitësit mundësi të plotë për të parë të gjitha shënimet, dokumentet, dosjet dhe të dhënat e lidhura me to, si dhe duke i siguruar mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj; (iii) të respektojë çdo udhëzim të Shitësit në realizimin e procedimeve ligjore dhe/ose negociatave zgjidhëse dhe/ose iniciativave të tjera në lidhje me të.

Në qoftë se Shitësi nuk arrin të japë instruksionet menjëherë pas marrjes së njoftimit përkatës nga Blerësi, Blerësi pa shkelur sa më sipër, merr të gjitha hapat e arsyeshme, të cilat mund të kërkojnë për të zvogëluar shumën, për të cilën kërkohet dëmshpërblimi, si dhe mundëson Shoqërinë të ndërmarrë të gjitha këto hapa të arsyeshme; si dhe do ta njoftojë Shitësin plotësisht dhe menjëherë për këto iniciativa dhe hapa.

Marrja nga Blerësi ose Shoqëria e ndonjë iniciative, në lidhje me këto pretendime, pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit ose mospërmbushja nga ana e Shoqërisë e dispozitave të mësipërme të këtij neni, bën që Shitësi të shkarkohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer Blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur humbja përkatëse është bërë e pagueshme.

Neni 10

Forca madhore

Mospërmbushja e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj kontrate prej ndonjë palë, nuk do të konsiderohet shkelje ose mospërmbushje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që pala e dëmtuar nga kjo ngjarje:

a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masa alternative të arsyeshme, për të plotësuar kushtet dhe afatet e kësaj kontrate;

b) të ketë njoftuar palën tjetër sa më shpejt që është e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë, brenda së cilës një palë, sipas kësaj kontrate, do të kryejë ndonjë veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën e kohës, gjatë së cilës kjo palë nuk ishte në gjendje që ta kryente këtë veprim për shkak të forcës madhore.

Neni 11

Përfundimi

Kjo kontratë mund të përfundohet vetëm për sa vijon:

a) me marrëveshjen reciproke me shkrim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit në datën e dhënë në të;

b) nga Blerësi para mbylljes, në qoftë se:

i) Shitësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 8.4, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 8.1 dhe 8.2 dhe Blerësi ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 8.3.

c) nga Shitësi para mbylljes, në qoftë se:

i) Blerësi prish ndonjë nga deklarimet dhe garancitë e nenit 6;

ii) Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 8.3, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 8.1 dhe 8.2.

Neni 12
Ligji që do të zbatohet dhe juridiksioni

Kjo kontratë rregullohet nga e drejta angleze.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe mbarimin e kësaj kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre arbitrash sipas rregullave të pajtimit dhe arbitrit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedimit të arbitrit do të jetë gjuha angleze.

Palët me anën e kësaj kontrate heqin dorë nga zbatimi i ndonjë rregulli tjetër statutor dhe deklarojnë se njohin rregullat e pajtimit dhe arbitrit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 13
Të ndryshme

13.1 Amendamentet

Asnjë amendament, modifikim, mbarim ose heqje dorë nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të jenë të vlefshme në asnjë rast, në qoftë se nuk bëhet me shkrim dhe nuk nënshkruhet nga ose në emër të secilës palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose të ndonjë mjeti mbrojtjeje, të parashikuar nga kjo kontratë ose me ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose nga mjeti mbrojtës, ose heqje dorë nga të drejta ose mënyra të tjera mbrojtëse. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose i një mjeti mbrojtës të parashikuar me këtë kontratë ose me ligj, nuk e pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose mjetit mbrojtës ose ushtrimin e një të drejte ose të një mjeti mbrojtës tjetër.

13.2 Ndashmëria

Në qoftë se ndonjë dispozitë ose detyrim, sipas kësaj kontrate, do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në ndonjë juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në asnjë mënyrë nuk do të ndikohen ose dëmtohen në ndonjë juridiksion tjetër.

Palët do të përpiqen të zëvendësojnë ndonjë dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme në masën më të madhe të mundshme për të arritur qëllimin e dispozitës së pazbatueshme ose të pavlefshme.

13.3 Kopjet

Kjo kontratë mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje dhe nga palë të ndryshme në kopje të veçanta, secila prej të cilave e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinale, por të gjitha këto kopje së bashku do të përbëjnë një instrument të njëjtë dhe të vetëm; faqet e firmosura mund të shkëputen nga kopjet e shumëfishta dhe të veçanta dhe mund t'i ngjiten një kopjeje të vetme, në mënyrë që të gjitha faqet e firmosura t'i ngjiten fizikisht të njëjtit dokument.

Dokumenti është në versionin anglisht dhe atë shqip. Në rast konflikti midis dy versioneve, përparësi do të ketë versioni anglisht.

13.4 Njotimet

Njoftimi ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë (më poshtë “Njoftimi”) do të jetë:

- me shkrim;
- në gjuhën angleze;
- i dorëzuar ose i dërguar me postë rekomande ose teleks, faks, palës që duhet ta marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo palë.

Me përjashtim të rasteve kur provohet se është marrë më shpejt, njoftimi konsiderohet i dhënë nëse:

- është dërguar me postë 10 (dhjetë) ditë-pune pas postimit të tij;
- është dërguar me telex, kur përgjigjja përkatëse është marrë;
- është dërguar me faks kur konfirmimi i transmetimit është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat që u referohen janë:

Blerësi

- Emri i palës: _____

- Adresa: _____
- Nr. Faksi: _____
- Dërguar në vëmendje të: _____

Shitësi

- Emri i palës: Ministria e Ekonomisë
- Adresa: Bulevardi Zhan d'Ark, Tiranë
- Nr. Faksi: +355 4 364 639
- Dërguar në vëmendje të: _____

13.5 Kalimi i të drejtave

Blerësi nuk mund të japë dhe të kalojë ndonjë të drejtë sipas kësaj kontrate në tërësi ose në veçanti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit, pëlqim i cili nuk mund të mos jepet pa arsye.

13.6 Kostot dhe taksat

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, secila palë do të paguajë shpenzimet e veta që lidhen me negociatat, përgatitjet, nënshkrimet dhe realizimin prej saj të kësaj kontrate dhe të secilit dokument të referuar në të.

13.7 Tërësia e marrëveshjes

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve në lidhje me objektin e kësaj kontrate.

SHITËSI

Shkëlqesia e Tij, Ministri i Ekonomisë

Për dhe në emër të Blerësit

Z. Anastas Angjeli

Z. _____